



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUPËRDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPËSTINA MËSINJA
SKENDERAJ
Nr. No. 02-060/01-0039781/20
Data Date 14-09-2020



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predçednika / Office of the Mayor

Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

Data: 15.01.2020

Vendi: Salla e Këshillit të Drejtorëve, në ndërtesën e komunës, Skenderaj

Ora: 14:00

RENDI I DITËS

- I. Miratimi procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
- II. Shqyrtimi i Draft Planit të KKSBB-së për vitin 2020;
- III. Siguria në komunikacion në sezonin e dimrit;
- IV. Fillimi i gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2019-2020;
- V. Të ndryshme.

Fjala hyrëse

Mbledhjen parë për këtë vit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi e hapi nënkryetari i Komunës së Skenderajt Nuredin Lushtaku i çili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi se para të gjithëve është draft plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), duke u bërë me dije që secili ta kontrolloj dhe nëse ka diçka për të shtuar atëherë le ta paraqes para të tjerëve.

Me pas fjalën e kërkoi Komandanti i Stacionit Policor në Skenderaj, **Basri Durmishi**, i diskutoj rreth planit të punës së KKSBB-së, ku përmendi ekipet vepruese duke thënë se ekipet vepruese nuk kanë funksionuar as në vitin 2019, ku rekomandoj që të gjendet një formë që të stimulohen aktivistet që qëndrojnë brenda, p.sh, shumë persona kanë hyrë dhe kanë dalur nga KLSP-ja për arsye të shumta, pasi që këta njerëz të vullnetit të mirë nuk paguhen,

komandanti propozoi që Kuvendi Komunal të gjej ndonjë formë që të motivoj këta persona që veprojnë brenda komunës, që se paku shpenzimet ditore me ua mbulu.

Nuredin Lushtaku: Faleminderit Komandant, ne do ti shohim se çfarë na lejon rregullorja dhe do të mundohemi t'i kemi parasysh ato që i paraqite si kërkesë, të shohim sa e lejon ligji.

Me pas fjalën e mori përfaqësuesi i Sektorit i Emergjencave Civile Komunale, **Sokol Hoxha**, i çili përkrahu Komandantin Durmishi në kërkesat e tij dhe propozoi që të përpilohet plani dhe me pas të shikohen edhe një herë mangësitë që mund të jenë në të.

Tutje Sokol Hoxha tha se në planin e punës janë përfshirë shumë pika të rëndësishme por që nuk do të thotë që janë të gjitha, pra mund të shtohet diçka tjetër, duke kërkuar edhe nga anëtarët e tjerë që të japin rekomandimet e tyre për të përfshirë gjitha pikat e sigurisë.

Basri Durmishi : Te pikat sa i përket planit te KKSB Këto janë pika që mund të ndryshojnë, ne i kemi gjashtë takime të parapara dhe nuk do të thotë që ne do të diskutojmë vetëm për këto pika çka janë këtu, ne në ndërkohë mund të na lind edhe ndonjë incident të çilat ne duhet ti fusim si pikë diskutimi ose ndonjë nevojë tjetër që ne duhet ti lemë këto pika dhe të merremi vetëm me atë çështje.

Nuredin Lushtaku: Çfarë do pike që na del jashtë planit do të merremi, ato janë të pa diskutueshme, mund te takohemi dhe ti zgjedhin çështjet qe janë emergjente edhe nëse është e nevojshme edhe 20 takime.

Me të gjitha votat pro u miratua edhe plani i punës së KKSB-së për vitin 2020.

Me pas në pikën e dytë të rendit të ditës fjalën e mori Komandanti i Rajonit të Policisë së Skenderajt, Basri Durmishi.

Basri Durmishi: Fillimisht po ua dorëzojë raportin e vitit 2019 ku krahasuar me vitin 2018, jemi - 5.7% në vepra penale -1.7%, kundërvajtje - 19.8%, aksidente trafiku 4.7%, tiketa, që është një punë aktive e policisë. Në vitin 2018 kemi pas 2919 tiketa ndërsa ne vitin 2019 kemi 2658 tiketa edhe pse nuk është pak kur ta shikojmë si shifër mbi 70% janë tiketa të paguara dhe të gjitha këto shkojnë në fondin e Kuvendit Komunal Skenderaj.

Sa i përket çështjes në siguri, aksidentet e renda, krahasim me vitet e kaluara ne kemi pas vetëm një rast me fatalitet, rreziku për të ardhmen është sepse faktor janë rrugët e rrëshqitshme dhe shumë faktor, siguria në trafik në përgjithësi është e mirë. Pikat e kontrollit janë në planifikim që të shtohen, në disa raste edhe shtimi shenjave, ku shenjat i kanë obligim kompanitë ti vendosin në distancën e caktuar me ligj. Po besoj se edhe tani në vitin 2020 do të kontribuojmë bashkë edhe me inspektor komunal në përmirësimin e trafikut. Nëse ka dikush diçka rreth planit ose edhe ndonjë pyetje tjetër jam i hapur.

Nuredin Lushtaku: Sa i përket personelit a e keni të paraparë numrin e policisë se sa është numri i popullsisë apo si e parasheh ligji apo keni ndonjë rregullore që e parasheh këtë pjesë se stafit tuaj.

Basri Durmishi: Në raportin e dhjetorit aty e keni të cekur moshën mesatare të policisë e cila në Skenderaj është 51 vjeçare, është një moshë pak e shtyrë, sikur të kishim pasur një moshë me të re mund ta kishim pas një staf me aktiv dhe me operativ. Stacioni i Skenderajt asiston në drejtorin e përgjithshme në Prishtinë me 13 zyrtarë policor 8 i kemi të familja e Presidentit 4 i kemi në akademi në Vushtrri, totali është 25 zyrtarë policor, d.m.th. këta i kemi jashtë , komplet jemi 98 zyrtarë policor. E kemi të rregulluar me udhëzim, kategoria A kategoria B, Kategoria C.

Nënkryetari Lushtaku bëri mbylljen e mbledhjes, ku edhe të gjithë të pranishmit u pajtuan që të vazhdojnë me bashkëpunimi mes të gjithëve që të menaxhohen në mënyrën me të mirë të mundshme të gjitha problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët e Skenderajt.

Procesverbal mbajtësi:



Endrit Nura

Kryetari i Komunës:

Bekim Jashari

